



MISIONI SHQIPTAR

E Lumja Nënë Tereza

Blessed Mother Teresa Albanian Mission
739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7
Tel. 416 503 4509 dhe 647 558 9382
www.misioninenetereza.com

Çdo të dielë në orën 12:30 Rruzarja dhe Mesha Shenjte

Zëri në shkreti

6 Dhjetor 2015



Në të pesëmbëdhjetin vit të sundimit të Tiberit Cezar, kur Ponc Pilati ishte qeveritari i Judesë, kur Herodi ishte tetrark i Galilesë, Filipi, vëllai i tij, tetrark i krahinës së Ituresë e i Trakonitidës, Lizania tetrark i Abilenës; kur Ana e Kajfa ishin kryepriftërinj, fjala e Hyjit i qe drejtuar Gjonit, birit të Zakarisë, në shkreti. Atëherë Gjoni e përshkoi mbarë krahinën e Jordanit duke predikuar pagëzimin e kthimit për falje të mëkateve në përkim me sa shkruan në librin e predikimeve të Isaisë profet: “Zëri i atij që bërtet në shkreti: përgatitni udhën e Zotit; rrafshoni shtigjet e tija! Çdo luginë le të mbushet, çdo mal e kodër le të ulet; udhët e shtrembra le të bëhen të drejta e ato gropa-gropa le të bëhen të rrafshta. E çdo njeri do ta shohë shëlbimin e Hyjit.” *Lk 3, 1-6*

Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 12:30 pm te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN'S LINE, Etobicoke**, M8W 3V7 (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union. Public transport: Brown's Line at Coules Court North Farside (15 m N) 123. Per me shume informacion shih faqen internet: www.ourladyofmm.com

Kalendari liturgjik...

07 Dhjetor	Shen Ambrozi
08 Dhjetor	Zoja e Paperlyer
10 Dhjetor	Zoja e Loretos
11 Dhjetor	Shen Damazi I
12 Dhjetor	Zoja e Guadallupes
13 Dhjetor	Shen Luçia

Haku Kishes 2015...

Deri tani kane dhene **Fabian Pllumaj, Ardian Preçetaj, Valmir Gjinaj:**

Aleks	Coku
Aleks	Dragu
Alfred	Shllaku
Altin	Miri
Anton	Malaj
Anton	Tinaj
Anton	Brunga
Arben	Pepa
Arben	Toma
Ardian	Precetaj
Astrit	Simeqi
Augustin	Bakaj
Beniamin	Hasko
David	Shtjefhilaj
Dritan	Lumaj
Edi	Linadi
Eduard	Shkreli
Elbert	Gashi
Fabian	Pllumaj
Fatmir	Qosaj
Franc	Shestani
Fred	Kalaj
Gac	Gjoka
Gezim	Vushaj

Gezim	Lanazi
Gjelosh	Vushaj
Gjergj	Gjinaj
Gjeto	Marinaj
Gjovalin	Ftoni
Ilir	Shyti
Ilir	Gjoka
Ilir	Daka
Kreshnik	Kapaj
Ladi	Lumaj
Lec	Gashaj
Lek	Tarazhi
Lek	Selmani
Leke	Kapllaj
Ljuc	Juncaj
Luk	Gjolaj
Lule	Tinaj
Luvigj	Lallinaj
Marash	Martinaj
Marin	Muzhani
Mario	Martini
Mark	Shkreli
Mark	Ndoci
Martin	Pjetri
Martin	Vukelaj
Mhill	Ftoni
Mhill	Bregu
Mirash	Lallinaj
Nik	Biqi
Nikolle	Lumaj
Nua	Selmani
Nue	Cacaj
Nush	Kaçaj
Pal	Rransburgaj
Paulin	Gjerkaj
Paulin	Lukani
Paulin	Qosaj
Paulin	Marku
Petrit	Ujka
Pjeter&Bep	Dreshaj
Prek	Spaqi
Prek	Lekaj
Preke	Gjonaj
Prel	Pepushaj
Shpend	Pllumaj
Sokol	Sokoli
Sokol	Ujka
Sokol	Sterbyci

Taulant/Elvis	Gjerkaj
Ton	Vocaj
Tonin Prek	Sufaj
Valmir	Gjinaj
Viktor	Pleti
Viktor	Gjokaj
Vitor	Mernacaj
Vladimir	Doda
Zef	Lulaj

Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!

Per Hakun e Kishes: Vini re...

Sikur eshte caktuar me vendim te shumices se anetareve **Haku Vjetor i Kishes** eshte 500 dollare dhe mund te jipet ne cash, check ose me credit card (shih faqen website misioninenetereza.com Donate Now for Blessed Mother Teresa Mission), **ne nje shume te vetme ose pjese pjese gjate vitit. Ata te cilet per arsye te ndryshme jane ne veshtiresi te kontaktojne drejperdrejt me famullitarin.**

Christmas Party....

Te shtunen 19 Dhjetor ne oren 7pm mbremje me muzike live ne support te Kishes tone!!!

Lëçitje Kunore martese...

Me 7 janar 2015 te Kisha famullitare e Bajzes (Arkidioqezja Shkoder-Pult) do te lidhin kunoren e shenje te martesës: Klement Hasaj (banues ne Mississauga) me Arta Nush Popaj (banuese ne Vukpalaj-Bajze).

Holy See warns against Christian discrimination at OSCE

(Vatican Radio) The Vatican's Secretary for Relations with States, Archbishop Paul Richard Gallagher, addressed the OSCE on Thursday, noting "the entire OSCE area, many persons and communities are subject to threats, acts of hostility and violence because of their racial, ethnic or religious identity." "Regarding intolerance and discrimination, one of the lessons learned in recent years is that it has become out-dated to talk about minority

and majority communities, since the victims may belong to either," Archbishop Gallagher said. "In particular, in the case of Christians, it is recognized that they suffer persecution in many countries, but even in countries where they are the majority they may also, in subtle ways, be subject to certain curtailments of their rights," he continued.



Të krishterët, më të persekutuarit në botë. Europarlamenti Evropian lëviz

Bashkësia e krishterë është më e sulmuara në botë nga urrejtja, dhuna, agresioni i vazhdueshëm. "Edhe pse persekutimi ndjehet më fort jashtë Evropës, Bashkimi Evropian duhet të reagojë para një situatë të tillë të rrezikshme, që mund të përhapet kudo": është ky pohimi i kryetarit të Europarlamentit, Schulz, i cili preku, këto ditë, në Bruksel, pikërisht temën e persekutimit të të krishterëve. Njerëz, që përndiqen vetëm për shkak të besimit të tyre në Krishtin. Iraku, Siria, Pakistani, Koreja e Veriut, Nigeria, janë vendet më të goditura nga fundamentalizmi. Të torturuar, të përdhunuar, të burgosur, me një fjalë, të persekutuar me të gjitha mënyrat e mundshme. Vetëm pse të krishterë. E janë 150 milionë, sipas të dhënave të Ojq-së Open Dors. Por ka edhe më: 700 mijë vetë kanë ikur nga Siria vetëm në katër vjet, 70% e të krishterëve është larguar nga Iraku që

nga viti 2013. Vetëm gjatë një viti, 4344 besimtarë janë vrarë e 1062 kisha janë djegur. Në Korenë e Veriut rreth 70 mijë njerëz janë ndër pranga për shkak të Ungjillit, ndërsa në Pakistan, çdo vit, 700 gra detyrohen të ndërrojnë fenë me dhunë. Nuk është aspak e vërtetë se të krishterët janë të ardhur në trojet, ku sot Islami është fe e shumicës. Prania e tyre në Lindjen e Mesme dhe në subkontinentin indian nis që në shekujt para përhapjes së Kuranit, siç shpjegoi edhe ipeshkvi ndihmës i Brukselit, imzot Malines Jean Kockerols, gjatë konferencës të nivelit të lartë, organizuar nga Parlamenti Evropian. Me këtë rast kryetari Schulz e ftoi BE-në të angazhohet për t'i mbrojtur të persekutuarit.

Por, sa kanë bërë deri tani institucionet evropiane?

Përgjigjet, në mikrofonin e Radio Vatikanit, **Alfredo Mantovani**, president i Lëvizjes Ndhimë për Kishën që Vuan:

Përgjigje: - Besoj se është më mirë të flasim për atë, që mund të bëjnë tani, menjëherë. E edhe në të ardhmen, sepse pak mund të thuhet për atë, që kanë bërë deri më sot. Denoncimi nuk mund të quhet pikarritje, shumë- shumë është vetëm pikënisje për të bërë diçka konkrete. Gjatë pesë vjetëve të fundit përqindja e të krishterëve ndërmjet refugjatëve, që arrijnë në Evropë, është rritur në 30%, gjë që tregon qartë se persekutimi vijon të bëhet gjithnjë më i egër. Veprimtari tjetër, që duhet pasur shumë parasysh, është që të ndërmerren nisma konkrete, që njerëzit e zonave të kërcënuara të mos kenë nevojë të ikin, duke braktisur gjithçka. Kur të krishterët dynden me shumicë nga disa troje, ky nuk është problem vetëm për secilin prej tyre e për familjet e tyre, por edhe për trojet prej nga ikin, që natyrisht, varfërohen pa masë.

Pyetje: - Ikje kjo, që pastaj mbështet idenë se janë të ardhur në viset e tyre, duke i krijuar Islamit mundësinë të bëhet feja sunduese...

Përgjigje: - Nëse duam të kemi një ide mbi atë, që do të ndodhë pas pak vjetësh - për të mos thënë pas pak muajsh - në zonat ku të krishterët jetojnë prej shekujsh, si Siria e Iraku, duhet të shikojmë praninë e krishterëve në jug të Mesdheut. Shën Agostini ishte ipeshkëv i Iponës. E çfarë ka mbetur sot nga bashkësia e krishterë në këto troje? Por Evropa i ndjek këto ngjarje me indiferencë, e indiferenca buron nga mosnjohja e fenomenit. Ne sot duhet ta pyesim mirë veten ç'mund të bëjmë për ta, por edhe për vete, sepse përvoja e tyre aktuale, mund të jetë edhe jona në të ardhmen e afërt. Nëse ne e fshehim identitetin tonë, gati-gati si të turpëroheshim prej tij, e sidomos me mendimin se mund të na shpëtojë nga aktet e dhunës kundër nesh, gabohemi rëndë. Kjo nuk funksionon, madje, po të kemi bindje të lëkundura për vete e për identitetin tonë, e gjithë kjo do ta bindë agresorin të jetë edhe më i vendosur në sulmin kundër nesh, ngaqë e di se nuk do të gjejë kurrfarë kundërshtimi. E po të mendosh se edhe në Evropë, ku nuk ka persekutim të mirëfilltë, si në vendet tjera, por ku nuk ka as respekt të plotë për lirinë fetare, mund të kalohet fare lehtë nga intoleranca, në diskriminim. E kjo, pa asnjë dyshim, do t'i hapte rrugën persekutimit. Sepse diskriminimi është paradhoma e persekutimit!

Offerings: Finding the true Jesus as Advent nears

